

REPublika e Kosovës - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRNE
Nr. / Br. 33532/25
Nr. i fq. / Br. st. -2-
Data: / Datum: 15.07.25
VUSHTPRI - VUČITRNE



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Komuna e Vushtrrisë
Opština Vučitrn – Municipality of Vushtri



Kuvendi i Komunës

01 Nr. PB 120/25, 15/07/2025

PROCESVERBAL

nga mbledhja e Komitetit për Komunitete, mbajtur më 25 qershor 2025 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:40.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin: Zdravko Zdravković (kryesues), Zojë Hajrizi, Kushtrim Hyseni, Behar Duraku, Gresa Muli, Berat Maloku, Zana Krasniç Saraçi, Aziz Emimi dhe Adem Hoti, anëtarë të komitetit.

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: përfaqësues të KFOR-it sloven, OSBE-së, UNMIK-ut, Aktore Dërvari - përkthyes, si dhe Bujar Klinaku nga sekretaria e kuvendit.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Zdravko Zdravković, kryesues i Komitetit për Komunitete, i cili konstatoi se ekziston shumica për punë. Ai kërkoi falje që nuk ka marrë pjesë në mbledhjen e kaluar, për shkak të obligimeve familjare.

Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit – lidhur me pikën 2, ai tha se ftesën ia kemi dërguar kryetarit të komunës, përmes sekretarisë së kuvendit, por fatkeqësisht nuk është i pranishëm. Pasi që kryetari nuk është i pranishëm, po e shoh të arsyeshme që ta heqim këtë pikë nga rendi i ditës.

Komiteti për Komunitete njëzëri votoi që ta heq nga rendi i ditës pikën 2 “Diskutim i hapur me Kryetarin e Komunës për problemet e Komunitetit”.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Komiteti për Komunitete njëzëri aprovoi procesverbalin nga mbledhja e kaluar.

2. Të ndryshme.

Aziz Emini, anëtar i komitetit – kam planifikuar disa pyetje për kryetarin, por ai nuk është i pranishëm. Po e përsëris prapë një shqetësim se në lagjen rome në Prelluzhë gjendet një antenë e lartë, e cila paraqet rrezik. Kam biseduar më herët me kryetarin e komunës për heqjen e kësaj antene. Ai më premtoi se do ta heqin, por ajo ende nuk është hequr.

Në lagjen tonë janë tri familje që nuk janë të kyçura në rrjetin e kanalizimit dhe se bëhet fjalë për 50 metra. Kur është rregulluar kanalizimi, ishte kohë me shi dhe kanë mbetur ato tri familje. Kemi pasur marrëveshje me kompaninë që kur të përmirësohet koha, të vijne që t'i kyçen në rrjet edhe ato tri familje, por deri më sot nuk ka përfunduar.

Si shqetësim tjetër është se qytetarët po vozitin shpejt në lagjen tonë. Andaj, kam kërkuar disa herë, po e ripërsëris që të vendosen pengesa (polic të shtrirë).

Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit – pajtohem me Azizin për problemet që i paraqiti për kanalizim dhe vozitje të shpejtë. Lidhur me kanalizimin, na kanë thënë se është çështje e kompanisë.

E falënderoj kryetarin e komunës për zgjidhjen e problemit të ujit të pijes në fshatin Prelluzhë. Ai tha se jemi kyçur në rrjetin e ri të ujësjellësit. Por, gypat e vjetër janë problem.

Berat Maloku, anëtar i komitetit – deklaroi se qenka bërë punë e mirë zgjidhja e problemit të ujit të pijes në Prelluzhë. Po e them një gjë se te asnjë kryetar, Komiteti për Komunitete nuk ka pasur reputacion. Mirëpo, edhe pse kërkesat tona nuk janë plotësuar 100%, së paku është vërejtur një interesim për të punuar. Besoj që deri në fund të mandatit do ta kemi të vështirë takojmë kryetarin, pasi që edhe pak fillon fushata zgjedhore. Mirëpo, ne të merremi me çështjen e komuniteteve tona. Temat që na lidhin me ndonjë drejtori, i ftojme në takim. Andaj, është mirë t'i vizitojmë disa familje së bashku me KFOR-in, OSBE-në e UNMIK-un, që sado pak t'ua japim një ngrohtësi familjeve se dikush po i viziton. Në mandatin tjetër, nuk do të jemi ndoshta të gjithë anëtarë të komitetit, por ta lëmë një punë të mirë.

Zdravko Zdravković, kryesues i komitetit – tha se në korrik i kemi të planifikuar dy mbledhje. Njërin ta mbajmë kah mesi i muajit. Kurse, mbledhja tjetër do të jetë më 30 korrik.

Behar Duraku, anëtar i komitetit – desha të ndërlihem me disa probleme që u paraqitën. Ai tha se sot do të ketë takim publik me qytetarë në Prelluzhë lidhur me planifikimin e buxhetit për vitin 2026, nga ora 18:00. Andaj, është vendi i duhur që t'i paraqisni këto shqetësime.

Mbledhja përfundoi në ora 11:10.

Bujar Klinaku

Procesmbajtës

